

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“PORTA” SHPK

Sot, në datën 18.04 .2019 (dymijë e nentembëdhjetë),

- Znj. Ilda SPAHIU, atesia Edmond, shtetase shqiptare, lindur më 29/10/1998, në Fier dhe banuese ne adresen Rr.”Andon Zako Cajupi” Tirane, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 032958622 dhe nr.personal J860290390.
- Z. Enton SPAHIU, atesia Edmond, shtetas shqiptar, lindur më 16/04/1995, në Fier dhe banues ne adresen Rr.”Andon Zako Cajupi” Tirane, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 032884341 dhe nr.personal J50416054M.

me cilesine e “Ortakeve Themelues”, te angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht ne Kodin Civil ne fuqi, legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare (ligjin 9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “ i ndryshuar), si edhe duke patur në dispozicion mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar ne daten e sotme, shpreh vullnetin dhe angazhimin për të themeluar një “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar”, si vijon:

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “PORTA” Shpk eshte person juridik i te drejtes shqiptare, e themeluar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar ose “SHPK” (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “PORTA” shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga Ortaket Ilda Spahiu dhe Enton Spahiu, te cilet përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Rr.”Andon Zako Cajupi””, Nd.14,H.15, Ap.12, Njesia Administrative Nr.5,



Nr.Pas.2/249+3-12, Zona Kadastrale 8270, prane supermarket "Conad", Tirane.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Veprimtaria e shoqerise do te jete:

- Krijim /ndertim, dizenjim, perditesim te faqeve se WEB-it (internet, online) dhe sherbimet e hostimit dhe mirembajtjes elektronike;
- Ofrimi i sherbimeve te konsulences se marketingut, perfshire ate online, promocionit dhe eventeve te ndryshme ;
- Ideimi dhe realizimi i reklamave, spoteve publicitare ne fushen e grafikes dhe dizajnit ;
- Kerkimi dhe seleksionimi i personelit; Kurse per pergatitjen dhe formimin e personelit ne fushen kontabël, fiskale, financiare dhe profesioneve te ndryshme.
- Analizë financiare për strategjitë e zhvillimit; Përgatitjen e planeve të financimit; Konsulencë dhe asistencë në operacionet e kredisë; Studim dhe kërkim burimesh financiare me kushte lehtësuese; Konsulencë në fushën e ndihmave dhe/ose kontributeve publike rajonale, kombëtare dhe Komunitare; Asistencë në operacionet e investimeve të paluajtshme;
- Menaxhim biznesi dhe ndermjetesim financiar rajonal dhe nderkombetar ;
- Asistencë në përgatitjen e biznes planeve; Asistencë në përgatitjen dhe zbatimin e programeve të rinstrukturimit dhe uljes së kostove ; Asistencë në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve ekonomike të jashtëzakonshme të shoqërive (*ristrukturime, bashkime, ndarje, zmadhime kapitali, blerje sipermarrjesh ose degësh të tyre; transformime, mbyllje dhe likuidim të shoqërive*).
- Ndërmjetësim për shit-blerjen e shoqërive; të blejë, nënshkruajë, investojë aksione, kuota, obligacione e tituj të ndryshëm të shoqërive të ndryshme; të blejë dhe nënshkruaj si dhe të disponojë të drejta mbi kuota/aksione apo interesa të ngjashme në shoqëri të ndryshme brenda dhe jashtë vendit
- Menaxhim i aktiviteteve artistike dhe sportive;
- Veprimtari në fushën e ndërtimit të të gjitha llojeve, duke përfshirë këtu ndërtime për qëllime banimi, ndërtime me karakter social, kulturor, industrial, kanalizime, rehabilitime rrugësh, ndërtimin e tyre etj., por gjithnjë duke mos u kufizuar vetëm në to dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në këtë fushë; shit-blerje apartamentesh, dhëniesh me qera, veprimtari real-estate, etj
- Veprimtari në fushën e tregtisë në përgjithësi, import-eksportit, duke përfshirë por jo kufizuar në import-ekport dhe shitblerje me shumicë dhe me pakicë të materialeve te ndertimit, mallrave industriale, metale me ngjyrë, mallrave ushqimore, blegtorale, bujqësore, materialeve të para, materialeve drusore dhe mobiljeve,
- Kryerje e te gjitha sherbimeve te tjera te nevojshme ndihmese, ne funksion te kryerjes se aktivitetit te shoqerise dhe qe nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Ortakeve.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000.000 Lekë (një milion leke).

Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota dhe zotërohet nga Ortaket e shoqërisë.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë kundrejt të tremeve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë;

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 7

Asambleja e Ortakeve

Asambleja e Ortakeve është organi më i lartë vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve, vendos edhe për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



Neni 8

Administrimi

Administrator i shoqërisë është z. **Enton Spahiu**.

Administratori e shoqërisë do të ushtroje kompetencat e administrimit për një afat 5 (pese) vjeçar. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakeve të shoqërisë.

Neni 9

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të veprimtarisë tregtare së shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së Ortakeve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e Ortakeve.
- Administratori, bazuar në një vendim të Asamblesë së Ortakeve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të Asamblesë së Ortakeve.
- Administratori nuk ka të drejtë të marri hua apo kredi në emër të shoqërisë, ai nuk ka të drejtë të nënshkruajë në emër të shoqërisë kontrata kredie, hipoteke, garancie, kontrata shitblerje apo qiraje. Të gjitha këto veprime mund të kryhen nga administratori vetëm me autorizim të posaçëm të Asamblesë së Ortakeve për çdo veprim të caktuar.
- Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Ortakeve për miratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- raportojë përpara asamblese në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori është i detyruar të thërrase mbledhjen e Asamblesë së Ortakeve edhe në rastet kur :
 - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
 - kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak



pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve, Zyrat e Tatim taksave, Doganave, Zyrave të qeverisjes vendore etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë dhe angazhon shoqërinë në këto marrëdhënie nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 10

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 11

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e tij;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë "Shoqëri në likuidim të siper".

Neni 12

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Per sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi redaktohet ne 3 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike.

Akti i mesiperm miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket Themelues te shoqerise tregtare "PORTA" Shpk, dhe nenshkruhet prej tyre ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen tyre orgjinale.

ORTAKET:

Ilda SPAHIU

Enton SPAHIU

Ilda Spahiu
IS

ES
Enton Spahiu